

**Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë**

**Departamenti për të Drejtat e Njeriut, Decentralizim dhe Komunitete**

**PLANIFIKIMI DHE IMPLEMENTIMI I STRATEGJISË  
KOMUNALE PËR KTHIM NË KOMUNAT E KOSOVËS**

*Prill- maj 2007*

## TABELA E PËRMBAJTJES

FJALORTHI I SHKURTESAVE:.....	2
1. HISTORIKU .....	4
2. METODOLOGJIA .....	5
3. PROCESI I HARTIMI TË STRATEGJISË KOMUNALE PËR KTHIM .....	5
4. PROCESI I IMPLEMENTIMIT TË STARTEGJISË KOMUNALE PËR KTHIM TË VITIT 2006.....	10
5. SHQYRTIMI I STARTEGJISË KOMUNALE PËR KTHIM TË VITIT 2006 .....	12
6. SISTEMI I PËRBASHKËT I RAPORTIMIT I ZYRTARIT KOMUNAL PËR KTHIM DHE ZKK.....	133
7. KONKLuzionET .....	13
8. REKOMANDIMET.....	14
9. SHTOJCA.....	16

## Fjalorth i shkurtesave:

ARC	Komiteti Amerikan për Refugjatë
KK	Komiteti për Komunitete
MQSH	Mekanizmi Qendror për Shqyrtim
KShE	Kryeshefi Ekzekutiv
NKK	Nënkryetarët e Kuvendit Komunal
DRC	Këshilli Danez për Refugjatë
PVPE	Plani i Veprimit për Partneritet Evropian
VSHI	Vizita shko e informohu
VSHSh	Vizitat shko dhe shiko
ICMC	Komisioni Ndërkombëtar Katolik për Migrim
PZHBV	Personat e Zhvendosur Brenda Vendit
PISK	Plani për Implementimin e Standardeve në Kosovë
Doracaku	Doracaku për Kthim të Qëndrueshëm
KK	Kuvendi Komunal
KKK	Kryetari i Kuvendit Komunal
KN	Komiteti për Ndërmjetësim
MCI	Mercy Corps International
ZKK	Zyrtari Komunal për Komunitete
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Zyrtari komunal për kthim - Zyrtari komunal për kthim	
SKK	Strategjia Komunale për Kthim
EK	Ekipi Komunal

GPKK	Grupi Punues Komunal për Kthim
NCA	Norwegian Church Aid (Ndihma e Kishës Norvegjeze)
OJQ	Organizata Joqeveritare
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
ZKM	Zyra e Kryeministrit
PNjK	Pilot Njësia Komunale
IPVQ	Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes
Rekomandimet -	Rekomandimet për azhurnimin e politikave dhe procedurave për kthim
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNHCR	Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë
DAC UNMIK	Departamenti i Administratës Civile pranë UNMIK-ut

## 1. Historiku

Gjatë vitit 2002 nevoja për krijimin e procedurave për të koordinuar dhe udhëzuar shumë akterë që ishin duke punuar në implementimin e projekteve për kthim në Kosovë u ë shumë e më shumë evidente. Si përgjigje ndaj kësaj nevoje, në maj të vitit 2002 Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) lëshoi dokumentin e tij për politikën e kthimit “E drejta për kthim të qëndrueshëm”.

Në mënyrë që parimet e politikave të cekura në këtë dokument të shkrihen në procedura praktike për planifikimin dhe menaxhimin e procesit të kthimit, për të formësuar koordinimin ndërmjet të gjitha palëve të interesit dhe për të plotësuar strategjinë vjetore të kthimit, UNMIK-u dhe IPVQ-të dhe Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ) në janar të vitit 2003, së bashku zhvilluan Doracakun e parë për Kthim të Qëndrueshëm (Doracaku), i cili ishte bazuar në praktikën më të mirë në fushën e kthimit të qëndrueshëm të pakicave.

Doracaku thekson standardet ndërkombëtare për të drejtat e personave të zhvendosur brenda vendit (PZHBV), kornizën përkatëse të politikave në Kosovë, rolet e institucioneve dhe përgjegjësitë e palëve të ndryshme të interesit, si dhe procedurat operative dhe mekanizmat për menaxhimin e procesit të kthimit individual dhe të organizuar të pakicave.

Si përgjigje ndaj kërkesave të parashtruara në Planin për Implementimin e Standardeve në Kosovë (PISK)<sup>1</sup>, ishte krijuar pozita e zyrtarit komunal për kthim dhe ishin rekrutuar zyrtarët e parë komunal për kthim nëpërmjet një vendimi të përbashkët të UNMIK-ut dhe IPVQ-ve gjatë gjysmës së dytë të vitit 2004. Plani për Implementimin e Standardeve në Kosovë (PISK) gjithashtu siguroi zhvillim të Strategjive Komunale për Kthim (SKK) për t’u siguruar që komunat të marrin përgjegjësinë për kthim të PZHBV-ve në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe ato evropiane. Në korrik të vitit 2004 UNMIK-u dhe IPVQ-të lëshuan një Dokument të Përbashkët mbi politikën komonale të strategjisë për kthim, i cili përfshinte një shabllon të propozuar dhe rekomandimet procedurale në lidhje me SKK-të.<sup>2</sup>

Në mars të vitit 2005 ishte krijuar Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK) me mandat, në mes tjerash, për të “monitoruar dhe përkrahur përpjekjet komunale për adresimin e çështjes së komuniteteve dhe kthimit, përfshirë edhe punën e komiteveve

---

<sup>1</sup> Planin për Implementimin e Standardeve në Kosovë, 31 mars 2004; Standardi IV Kthimi i Qëndrueshëm dhe të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre, 1. Kthimi i Qëndrueshëm, Standardi 1. “Komunat dhe ministritë kanë mundësi që të marrin përgjegjësitë për kthimin e të gjitha komuniteteve në atë mënyrë që është në përputhshmëri me standardet evropiane.”, Veprimi 1.4 “Çdo komunë zhvillon strategjinë për kthim dhe komunitete për vitin 2004 dhe vitet në vijim dhe strategjitë implementohen në mënyrë të efektshme.”, dhe Veprimi 1.5 “Çdo komunë me kthime të vazhdueshme apo të projektuara ka krijuar dhe plotësuar vendin e punës për zyrtar komunal për kthim sipas termeve të duhura ekzistuese të referimit”.

<sup>2</sup> Dokumenti i përbashkët i politikave të UNMIK-IPVQ mbi strategjinë e kthimeve në komunë, korrik 2004, i bashkangjitur si shtojca 1.

për ndërmjetësim (KN), komiteteve për komunitete (KK), Zyrave Komunale për Komunitete dhe zhvillimin dhe implementimin e Strategjive Komunale për Kthim.”<sup>3</sup>

Në maj të vitit 2006, si rezultat i procesit të konsultimeve gjithëpërfshirëse që kishin përfshirë të gjitha palët e interesit si kombëtare ashtu edhe ndërkombëtare, përfshirë shoqatat e PZHBV-ve, Zyra e Kryeministrit (ZK) kishte miratuar Rekomandimet për Procedurat dhe Politikat e Azhuruara për Kthim (Rekomandimet). Duke u bazuar në Rekomandimet, është ndryshuar Doracaku, si dhe Doracaku i Rishikuar për Kthim të Qëndrueshëm, i nënshkruar nga ZKM i cili ishte prezantuar në korrik të vitit 2006. Në këtë mënyrë, SKK ishte përshkruar si “mjet proaktiv për të analizuar ambientin/situatën e kthimit, për të identifikuar sfidat, për të përcaktuar rajonet, për të propozuar veprimet, dhe për të ndarë, ose për të kërkuar burimet e nevojshme për të lehtësuar dhe implementuar efektivisht procesin e kthimit.”<sup>4</sup>

## **2. Metodologjia**

Raporti është i bazuar në vlerësimin e bërë nga Ekipet Komunale të OSBE-së (EK) në prill dhe në maj të vitit 2007 (në tekstin e mëtejshëm “anketa”). Informatat ishin mbledhur pjesërisht nëpërmjet intervistimeve të akterëve relevantë komunal dhe pjesërisht nëpërmjet monitorimit dhe përfshirjes së drejtpërdrejt të EK-ve. Në disa komuna EK-të kishin qenë drejtpërsëdrejti të angazhuara në procesin punues me përfaqësuesit komunal duke i këshilluar ata për aktivitetet dhe procedurat konkrete që kanë të bëjnë me punën e GPKK-ve, zhvillimin e SKK-ve dhe çështje tjera. Kjo anketë i ka mundësuar OSBE-së të analizojë proceset nëpërmjet të cilave SKK ishin planifikuar dhe implementuar në 30 komuna të Kosovës.<sup>5</sup> Pilot Njësitë Komunale (PNjK) nuk janë përfshirë në këtë raport, pasi ato ende nuk kanë krijuar struktura përkatëse për menaxhimin e procesit të kthimit. Në komunën e Glllogoc/Glogovac nuk ekziston asnjë mekanizëm menaxhues.

## **3. Procesi i hartimit të Strategjisë Komunale për Kthim**

Dokumenti i përbashkët mbi politikat e UNMIK-ut dhe IPVQ-ve rekomandon që në tetor të çdo viti të rishikohen SKK-të për secilin vit dhe SKK-të të miratohen nga ana e Grupit Punues Komunal për Kthim (GPKK) deri më 31 dhjetor. Rezultatet e anketës tregojnë që në kohën e publikimit të këtij raporti, SKK të për vitin 2007 janë miratuar në 22 komuna të Kosovës. Shtatë komuna, pra Mitrovica/Mitrovica, Leposavić/Leposaviq, Zubin Potoku, Zvečan/Zveçan, Gjilani/Gnjilane,

<sup>3</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/15, për ndryshim të Rregullores së UNMIK Nr. 2001/19 mbi Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, Shtojca XII, para. (viii).

<sup>4</sup> Doracaku i rishikuar për Kthim të Qëndrueshëm, korrik 2006, faqe 37, pjesa “Strategjia Komunale për Kthim”.

<sup>5</sup> Deçan/Deçani, Gjakovë/Đakovica, Glllogoc/Glogovac, Gjilan/Gnjilane, Dragash/Dragaš, Istog/Istok, Kaçanik/Kaçanik, Klinë/Klina, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Kamenicë/Kamenica, Mitrovicë/Mitrovica, Lipjan/Lipljan, Novobërdë/Novo Brdo, Obiliq/Obilić, Rahovec/Orahovac, Pejë/Peć, Podujevë/Podujevo, Prishtinë/Priština, Prizren, Skenderaj/Srbica, Shtime/Štimlje, Suharekë/Suva Reka, Ferizaj/Uroševac, Viti/Vitina, Vushtrri/Vučitrn, Malishevë/Mališevo, Leposavić/Leposaviq, Štrpce/Shtërpçë, Zubin Potok dhe Zvečan/Zveçan.

Kaçaniku/Kaçanik dhe Malisheva/Mališevo, nuk kishin miratuar SKK-të brenda kësaj kohe për arsye të ndryshme.

Në Mitrovicë/Mitrovica, si dhe në tri komunat veriore Leposavić/Leposaviqi, Zubin Potok dhe Zvečan/Zveçan nuk është krijuar asnjë SKK për shkak të arsyeve specifike politike, përderisa komunat veriore të dominuara me serbë të Kosovës refuzojnë çdo bashkëpunim me IPVQ-të dhe përputhshmëri me udhëzuesit e lëshuar nga IPVQ-të.

Andaj, ka ende PZHBV shqiptarë të Kosovës nga komuna e Leposaviqit/ Leposavić që nuk janë kthyer nëpër shtëpitë e tyre, përderisa komuna e Zvečan/Zveçan është duke i strehuar më se 4,000 PZHBV serbë të Kosovës.<sup>6</sup> Duhet të hapen kanale të komunikimit dhe mënyra të bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve komunale për t'i ndihmuar ata të cilët dëshirojnë ta ushtrojnë të drejtën për t'u kthyer në vendin e tyre të origjinës.

Kuvendi Komunal (KK) në Mitrovicë/Mitrovica nuk e ka miratuar SKK-në si rezultat i mosmarrëveshjeve të brendshme ndërmjet fraksioneve të ndryshme politike dhe për shkak të detyrës së pamundur të implementimit të strategjisë në pjesën veriore të qytetit të dominuar nga komuniteti serb e cila është jashtë kontrollit të Komunës.

Në Gjilan/Gnjilane, Kaçanik/Kaçanik dhe Malishevë/Mališevo mosmiratimi i SKK-së pasqyron mungesën e vullnetit politik në autoritetet komunale për të krijuar kushte për kthim të PZHBV-ve nga komunitetet pakicë. Si në komunën e Gjilanit/Gnjilane, ashtu edhe në komunën e Kaçanikut/Kaçanik ishte miratuar vetëm nga një SKK në vitin 2004 që mëton të mbulojë periudhën trevjeçare prej 2005 deri 2007. në të dyja rastet, që nga atëherë, nuk është zhvilluar asnjë plan i implementimit e as ndonjë azhurnim i strategjisë, gjë që është një tregues i mungesës së përkushtimit në procesin e kthimit. Modeli i strategjisë trevjeçare gjithashtu ishte përdorur në komunat tjera, mirëpo në ato raste Strategjia ishte e azhurnuar dhe rishikuar çdo vit.

Informata e mbledhur nga EK-të e OSBE-së zbulojë që rëndësia e një procesi përfshirës konsultativ të planifikimit i cili bashkon idetë dhe kontributet e aktorëve të ndryshëm ishte kuptuar dhe shqyrtuar nga autoritete të ndryshme komunale.

Komunat e Podujevës/Podujevo, Istogut/Istok, Pejës/Peć dhe Suharekës/Suva Reka shërbejnë si shembuj pozitiv për një SKK të zhvilluar nëpërmjet një procesi të hapur konsultativ, me përfshirje dhe kontribut aktiv të akterëve të ndryshëm, përfshirë PZHBV-të dhe përfaqësuesit të tyre. Këta të fundit ishin gjithashtu të azhur në mënyrë aktive në hartimin të SKK-së në komunën e Obiliqit/Obilić, dhe SKK-së në Deçan/Dečani ku në mënyrë të veçantë kishin inkurajuar pjesëmarrjen e PZHBV-ve në procesin e hartimit. Ndonëse në Rahovec/Orahovac PZHBV-të dhe përfaqësuesit e tyre ishin përfshirë vetëm sipas këshillës ose kërkesës nga akterët ndërkombëtarë siç janë Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR), OSBE-ja dhe Departamenti për Administratë Civile pranë UNMIK-ut (DAC UNMIK).

Një proces i ngjashëm i hartimit ndërveprues ishte bërë në Dragash/Dragaš dhe Prizren, edhe pse në këto komuna kishte munguar pjesëmarrja dhe kontributi i faktorit të rëndësishëm siç është PZHBV. Përfaqësuesit e PZHBV-ve nga Prizreni kishin

---

<sup>6</sup> Informatë e siguruar nga Qendra Rajonale e OSBE-së në Mitrovicë/Mitrovica.

hartuar rekomandimet gjatë një punëtorie për PZHBV-të të organizuar nga Këshilli Danez për Refugjatë (DRC) ku kishin marrë pjesë edhe përfaqësuesit e IPVQ-ve të nivelit lokal dhe qendror. Ato rekomandime dhe komente iu ishin prezantuar ushtruesit të detyrës së zyrtarit komunal për kthim, i cili kishte refuzuar që t'i fus ato në projekt SKK-në. Në dy komunat e përmendura, si edhe në një numër komunash tjera, ka mundësi për përmirësim të komunikimit ndërmjet autoriteteve komunale dhe komuniteteve që janë PZHBV. Roli kyç dhe përgjegjësitë e Zyrtarëve Komunal për Kthim, me përkrahjen e disa akterëve tjerë komunal, është që të bëjë kontakte aktive me këto komunitete si dhe t'i vizitoj ato.

Në disa komuna, për shembull në Prishtinë/Priština dhe Pejë/Peć, pjesëmarrja e PZHBV-ve është penguar për shkak se disa institucione komunale nuk kishin siguruar përkthimet në gjuhën serbe dhe dorëzimin me kohë të dokumenteve të hartuara në mënyrë që PZHBV-të të kenë mundësinë për ta shqyrtuar dhe për të dhënë komentet e tyre.

Rezultatet e anketës në përgjithësi janë duke treguar një nivel modest të përgjithshëm të përfshirjes së akterëve komunal në procesin e hartimit. Siç është rekomanduar nga Udhëzimet e përbashkëta të UNMIK-IPVQ për Zhvillim të Strategjisë i shpërndarë në qershor të vitit 2004, kryetari i kuvendit komunal (KKK) dhe Kryeshefi Ekzekutiv (KShE) duhet ta marrin udhëheqjen e procesit të zhvillimit të strategjisë.

Është vërejtur se zyrtarët komunal për komunitete (ZKK) ishin përfaqësuesit më të përfshirë komunal, së bashku me zyrtarët komunal për kthim, të cilët kishin kontribuar në zhvillimin e SKK-ve në gjysmën e komunave (11 prej 22). Në anën tjetër, kryetarët e kuvendeve komunale dhe KShE-të kontribuuan vetëm në shtatë komuna. KK-te, organizatat joqeveritare (OJQ) vendore dhe akterët e shoqërive civile ishin konsultuar në katër komuna, përderisa nënkryetarët e kuvendeve komunale (NKK) dhe drejtorët e departamenteve komunale dhe koordinatorët komunal për standarde kontribuuan në tri komuna. Komitetet për ndërmjetësim, zyrtarët komunal për barazi gjinore dhe KN-të ishin organet komunale që më së paku ishin konsultuar (vetëm nga një herë secili).

Sa i përket çështjes gjinore, ia vlen të theksohet që aspektet gjinore si përfaqësimi i barabartë i interesave PZHBV-ve nga femrat dhe meshkujt sipas Planit për Implementim të Standardeve për Kosovën<sup>7</sup> dhe Planit të Veprimit për Partneritet Evropian (PVPE)<sup>8</sup>, ishin trajtuar në vetëm katër nga 22 SKK.

Në një rast përjashtimi (Mitrovicë/Mitrovica), ishin konsultuar Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK), Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK), dhe udhëheqësit e fshatrave dhe të lagjeve, gjë që pasqyron një kuptim të mirë të qëllimit dhe synimit të konceptit të planifikimit strategjik dhe qasjes proaktive të autoriteteve komunale.

---

<sup>7</sup> Plani për Implementimin e Standardeve në Kosovë, 31 mars 2004; Standardi IV Kthimi i Qëndrueshëm dhe të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjestarëve të tyre, 1. Kthimi i Qëndrueshëm, Standardi 1. “1. Komunitet dhe ministritë janë në gjendje të marrin përgjegjësi për kthimin e të gjitha komuniteteve në përputhje me standardet Evropiane.”; Veprimi 1.7 “Të sigurohet që përfaqësuesit e femrave të komuniteteve, të kthyerve dhe PZHBV-ve të janë të përfshirë në vendimmarrje dhe planifikim për çështjet e kthimeve dhe komuniteteve në të gjitha nivelet”.

<sup>8</sup> Plani i Veprimit i Kosovës për Implementimin e Partneritetit Evropian 2006, gusht 2006, Prioriteti Nr. 28, Veprimi Nr. 9 “Përfshirja e komuniteteve, të kthyerve, përfaqësuesve të femrave në çështjet e vendimmarrjes dhe planifikimit”.



Është raportuar që në dy komuna, Prishtinë/Priştina dhe Mitrovicë/Mitrovica, MKK është përfshirë në hartimin e SKK-së. Me komunat që vazhdimisht rrisin kërkesën për këshilla dhe udhëzime për çështjen e zhvillimit të politikave për kthim, implementim dhe shqyrtim, është evidente nevoja e madhe për të forcuar edhe më tutje lidhjet ndërmjet nivelit qendror dhe atij komunal të IPVQ-ve, e në veçanti në forcimin e kapaciteteve të Ministrisë për të luajtur rol më aktiv në këtë proces, nëse kërkohet nga komunat. MKK mund t'i shtojë vlera të mëdha këtij procesi duke identifikuar dhe shumëzuar praktikatat e suksesshme, duke zbuluar dobësitë dhe duke promovuar këmbim të përvojave dhe informatave ndërmjet zyrtarëve komunal.

Duhet të theksohet që organizatat e PZHBV-ve dhe përfaqësuesit e tyre, që janë një prej faktorëve kryesor në procesin e kthimit dhe grupi kryesor i synuar i MKK-së, janë përfshirë në procesin e hartimit në vetëm nëntë (nga 22) komuna me SKK të miratuar. Kjo jo vetëm që është kundërtënëse me frymën dhe parimet e vendosura në Doracakun e Rishikuar mbi Kthimin e Qëndrueshëm, por kjo gjithashtu tregon mungesën e vetëdijes dhe të kuptuarit të roleve dhe përgjegjësisë të zyrtarëve komunal për kthim dhe KKK-ve për vendosjen e kontakteve me komunitetin e PZHBV-ve me prejardhje nga komuna e tyre, për t'i pajisur ata me informata relevante dhe për t'i siguruar që shqetësimet e tyre janë dëgjuar dhe janë marrë parasysh me kohë në GPKK. Prandaj, forcimi i pjesëmarrjes së PZHBV-ve në planifikimin e politikave për kthim dhe implementim duhet të jetë një fushë tjetër për ndërhyrje nga MKK-ja.

Shembulli i komunës së Fushë Kosovës/Kosovo Polje, megjithatë, ilustron se si e madje pa pjesëmarrje të drejtpërdrejtë të PZHBV-ve në procesin e hartimit, mund të gjenden mënyra alternative nga institucionet komunale për të arritur deri te këto komunitete dhe për t'i përfshirë ato. Në këtë rast, autoritetet komunale aplikuan vizitën 'shko dhe informo' vetëm në Serbi për t'ia prezantuar draftin e SKK-së komunitetit të PZHBV-ve atje. Si rezultat, PZHBV-të kanë qenë në gjendje t'ia dorëzojnë komentet GPKK-së.

Si në çështjet procedurale, ashtu edhe në atë përmbajtjesore është ofruar mbështetje dhe udhëzime të konsiderueshme nga aktetë ndërkombëtar në të gjitha fazat e procesit të zhvillimit të strategjisë, qoftë përmes organizimit të punëtorive tematike rajonale dhe përmes pjesëmarrjes së tyre në Komisionet Komunale për Zhvillimin e Strategjisë ose Grupet Vepruese apo duke komentuar mbi draft dokumentet e prezantuara. OJQ-të ndërkombëtare janë faktorë të rëndësishëm në procesin e kthimit, për shkak të mundësive të tyre në lehtësimin e kontakteve ndërmjet PZHBV-ve dhe IPVQ-ve dhe shpërndarjes së informatave komunitetit të zhvendosur brenda vendit, por gjithashtu edhe përmes përvojës së tyre në planifikimin dhe menaxhimin e projektit si dhe përmes kontributeve financiare ose financimit të projekteve të tëra për kthim. Ata kanë dhënë kontribut të rëndësishëm për SKK-të në dhjetë komuna.

Dokumenti i përbashkët i UNMIK-ut dhe IPVQ-ve mbi Politikën për SKK-të, rekomandon që të merret parasysh themelimi i Komisioneve/Grupeve Vepruese për SKK i kryesuar nga KKK-ja së bashku me KShE-në dhe ZKK-në si anëtarë. Në nëntë nga 225 komuna rekomandimi u pranua dhe u themeluan komitetet komunale apo grupet e veprimit. Janë zgjedhur përbërje të ndryshme me UNHCR-in, DAC-in e UNMIK-ut si anëtar në gjashtë komisione, prej nëntë komisioneve/grupeve vepruese.

Në komunën e Suharekës/Suva Reka është themeluar Komisioni Komunal për hartimin e SKK-së, ku nuk është përfshirë asnjë prej akterëve të rekomanduar, por ky komision përbëhej prej një drejtori komunal, një ekonomisti të punësuar në komunë dhe një juristi. Megjithatë, komuna pati sukses në realizimin procesit gjithëpërfshirës konsultativ dhe në arritjen e konsensusit ndërmjet të gjithë akterëve relevant, si në institucionet komunale ashtu edhe në ato jashtë institucioneve komunale, përfshirë përfaqësuesit e PZHBV-ve për SKK-në e vitit 2007.

Komiteti komunal ose grupi veprues mund të jetë një mjet efektiv në procesin e planifikimit strategjik, kur të mbliidhen të gjithë akterët me njohuri të thella të kushteve të rëndësishme për kthim në komunë dhe me përvojë të madhe në çështjet procedurale dhe të politikave për udhëheqjen e procesit dhe hartimin e draft dokumentit të cilësisë së lartë që mund të elaborohet dhe plotësohet më tej nga akterët tjerë. Megjithatë, ky nuk është opsioni i vetëm në dispozicion për zhvillimin e një strategjie të realizueshme, që shihet si rezultat i punës. Dokumenti mbi politikën e UNMIK-IPVQ rekomandon këtë opsion, duke lënë identifikimin e mënyrave dhe mjeteve tjera në diskrecion të autoriteteve komunale, bazuar në situatën specifike në çdo komunë. Kjo edhe një herë konfirmon nevojën që niveli qendror i IPVQ-ve të vendos dhe ruaj kontaktet e rregullta me komunat dhe të krijojë mekanizma që sigurojnë bashkërendim, informim dhe shkëmbim të praktikave më të mira ndërmjet komunave.

Në 12 komuna<sup>9</sup> është bërë procesi i konsultimit publik, përmes së cilit draft dokumenti i strategjisë është prezantuar para publikut. Në 11 raste, janë pranuar komente pas prezantimit, gjë që ka dëshmuar interesim të lartë për kthim dhe për proceset e zhvillimit të strategjisë.

Në 21 komuna, zyrtarët komunal për kthim ishin në dijeni për udhëzimet e IPVQ-ve dhe UNMIK-ut mbi SKK-të dhe për shabllonët e propozuara për SKK-të, me ç'rast edhe i shfrytëzuan ato. Në tetë komuna<sup>10</sup> zyrtarët komunal për kthim nuk kishin njohuri për udhëzimet dhe shabllonin, ndërsa në tri prej tetë komunave, zyrtarëve komunal për kthim iu janë dhënë udhëzimet nga EK-të e OSBE-së ose nga përfaqësuesi i DAC-i i UNMIK-ut gjatë procesit të hartimit.

Është raportuar një rast i vetëm, saktësisht nga komuna e Prizrenit, ku ushtruesi i detyrës së zyrtarit komunal për kthim e konfirmoi se kishte njohuri për udhëzimet dhe shabllonët, megjithatë ka zgjedhur të mos i përdorë por të paraqet një strukturë tjetër për SKK-në në vend të saj. Në katër komuna janë shfrytëzuar shabllonë të ndryshëm nga ai që është propozuar në udhëzimet e UNMIK-ut - IPVQ-ve.

Analizat e SKK-së në këto komuna tregojnë, që në parim komponentët kryesore si përshtetja e situatës në komuna lidhur me kthimin, përqendrimet, objektivat dhe sfidat janë mbuluar në një mënyrë apo tjetër. Të gjitha këtyre strategjive, sidoqoftë, u

<sup>9</sup> Deçan/Deçani, Istog/Istok, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Kamenicë/Kamenica, Novobërdë/Novo Brdo, Obiliq/Obilić, Podujevë/Podujevo, Prishtinë/Priština, Skenderaj/Srbica, Shtime/Štimlje, Ferizaj/Uroševac dhe Vushtrri/Vučitër.

<sup>10</sup> Gjilan/Gnjilane, Kaçanik/Kaçanik, Novobërdë/Novo Brdo, Rahovec/Orahovac, Viti/Vitina, Vushtrri/Vučitër, Zubin Potok dhe Zvečan/Zveçan.

mungonte një pasqyrë e burimeve që kërkoheshin për implementimin e aktiviteteve të sugjeruara dhe projektimet specifike buxhetore. Veç kësaj, në disa SKK, të cilat i janë përmbajtur shabllonit të rekomanduar, informatat e dhëna nën komponentin ‘burimet’ ishin shumë e përgjithësuara, ndonjëherë të kufizuara në ankesë rreth mungesës së mjeteve financiare në dispozicion në komunë. Një pasqyrë e hollësishme financiare dhe burimet që kërkohen për të plotësuar objektivat e propozuara është një element themelor i strategjisë së realizueshme dhe parakusht për implementimin e saj të suksesshëm. Kjo sugjeron, që duhet t’i kushtohet vëmendje e veçantë ofrimit të udhëzimeve të mirëfillta në çështjet e planifikimit të burimeve, për akterët komunal, të cilët janë përgjegjës për realizimin e procesit të hartimit të SKK-së.

#### **4. Procesi i implementimit të Strategjisë Komunale për Kthim për vitin 2006**

Vlerësimi i implementimit të SKK-ve për vitin 2006 tregon që asnjë prej komunave nuk ia kanë dalë që plotësisht t’i arrijnë synimet e projektuara që ishin të vendosura në SKK. Ky vlerësim është bërë duke u bazuar në pesë komponentët e strategjisë (situata e tanishme, fushat e përqendrimit, sfidat, veprimet e propozuara, kërkesat për burime) siç është propozuar në Dokumentin e Strategjisë të UNMIK-ut dhe IPVQ-ve dhe duke e aplikuar shkallën e vlerësimit me tri nivele “plotësisht e implementuar/pjesërisht e implementuar/aspak e implementuar.” Niveli më i lartë i implementimit është vlerësuar në komunën e Istogut/Istok, ku tre prej pesë komponentëve janë implementuar plotësisht dhe dy janë implementuar pjesërisht. Në 16 komuna, SKK-ja është vlerësuar si pjesërisht e implementuar, ku së paku tri prej pesë komponentëve janë vlerësuar të jenë pjesërisht të implementuar.

Në tri komuna, vlerësimi tregon që SKK-të për vitin 2006 nuk janë implementuar në (Obiliq/Obilić, Pejë/Peć dhe Shtime/Štimlje). Në komunën e Obiliqit/Obilić nuk është miratuar zyrtarisht asnjë SKK në vitin 2006. Në rastin e komunës së Pejës/Peć nuk ishte e mundur të realizohej një vlerësim real i nivelit të implementimit për shkak të cilësisë së dobët të strategjisë dhe për faktin, se pjesë të strategjisë janë shkëputur dhe bashkëngjitur nga një numër dokumentesh të drejtorive të ndryshme, shumica prej të cilave kishin shumë pak lidhje me kthimin. SKK-ja e Shtimes/Štimlje është vlerësuar si e paimplementuar, ngase projekti i vetëm për kthim i cili është konsideruar të jetë aktiviteti thelbësor i SKK-së dhe që tanimë është miratuar nga Mekanizmi Qendror për Shqyrtim (MQSH), nuk ka mundur të impementohet për shkak të mungesës së fondeve.

Këto rezultate, deri në njëfarë mase pasqyrojnë zbrazëtirat e fazës së planifikimit, ato ilustrojnë nevojën për përmirësimin e cilësisë së planifikimit strategjik nëpër komuna dhe nevojën për udhëheqje të përqendruar nga IPVQ-të qendrore. Një proces planifikimi i mirëfilltë, duke përfshirë analizën e rreziqeve dhe sfidave, bazuar në vlerësimin real të faktorëve që ndikojnë në kthimin nëpër komuna dhe në përpjesëtimin e balancuar mirë në mes të burimeve në dispozicion dhe rezultateve të projektuara, do të lejonte implementim më të suksesshëm të SKK-së. Një vlerësim i saktë i të gjitha komponentëve do të ndihmonte në reduktimin e mospërputhjeve ndërmjet synimeve të parashikuara, objektivave dhe arritjeve aktuale. Veç kësaj, do t’ia vlente të rimerret në konsideratë planifikimi strategjik në periudhë prej një viti, duke e pasur parasysh dinamikën specifike të procesit të kthimit dhe aspektet përkatëse.

Duke i shikuar pengesat dhe kufizimet kryesore me të cilat ballafaqohen komunat gjatë procesit të implementimit, faktorët e cituar më së shpeshti përfshijnë:

- mungesën e fondeve për projektet e kthimit;
- situatën e pafavorshme politike për kthim në komunë ose supozimin e sigurisë së pamjaftueshme për të kthyerit;
- mungesën e vullnetit politik ose përkushtimit të zyrtarëve komunal ndaj procesit të kthimit;
- mungesën e qasjes në shërbime komunale;
- mungesën e qasjes në arsimim;
- mungesën e mundësive për punësim/mundësi ekonomike;
- mungesën e qasjes në pronë/kërkesa të pazgjdhura të pronës;
- mungesën e koordinimit ndërmjet akterëve të përfshirë në procesin e kthimit;
- mungesën e kapaciteteve për përkthim në gjuhën serbe në komunë; dhe
- mungesën e financimit për zyrtarin komunal për kthim.

Është e rëndësishme të theksohet, që ndonëse kjo ka ndodhur vetëm në disa raste, mungesa e pjesëmarrjes dhe qasja konstruktive nga PZHBV-të ose përfaqësuesit e tyre është përmendur gjithashtu si një pengesë. Prandaj, nuk mund të theksohet sa duhet rëndësia që vetë komunitetet e PZHBV-ve të tregojnë interes dhe të marrin pjesë aktive në të gjithë mekanizmat menaxhues në dispozicion për kthim në të gjitha nivelet dhe të kontribuojnë në planifikimin e kthimit dhe implementimit në mënyrë konstruktive.

Përgjigjet për pyetjet mbi akterët, të cilët kanë mbështetur veçanërisht implementimin e SKK-së, kanë theksuar që në kuadër të institucioneve komunale, KKK dhe zëvendësit e tyre, KShE-të, ZKK-të dhe zyrtarët komunal për kthim kanë qenë përkrahësit më aktiv. Në komunën e Prizrenit ishin mu KN-ja dhe Bordi i Drejtorëve, të cilët treguan angazhim të veçantë. Akterët komunal janë treguar të jenë veçanërisht përkrahës në 12 komunat.<sup>11</sup> Këto rezultate tregojnë që rolet dhe përgjegjësitë kryesore për implementimin e kthimit janë kuptuar dhe ushtruar mirë nga akterët komunal. Megjithatë, në më shumë se gjysmën e komunave nuk ishte kështu dhe nevojitet që të shtohen përpjekjet e të gjithë akterëve në IPVQ për të përmirësuar këtë gjendje.

Nuk duhet të zhvlerësohet roli lehtësues i akterëve tjerë në komunë, siç tregon shembulli i Runikut/Rudnik në komunën e Skenderajt/Srbica. Në këtë rast, kryeplaku ka luajtur një rol të jashtëzakonshëm në mbështetjen e marrëdhënieve ndërmjet PZHBV-ve brenda vendit dhe komunitetit pranues. Në dy komunat, Istog/Istok dhe Kamenicë/Kamenica, është vënë re mbështetja financiare nga Ministria për Komunitete dhe Kthim.

OJQ-të ndërkombëtare që janë aktive në rajonet përkatëse siç janë: Këshilli Danez për Refugjatë (DRC), Ndihma e Kishës Norvegjeze (NCA), Këshilli Amerikan për Refugjatë (ARC), 'Mercy Corps International' (MCI), CARE dhe 'Këshilli Ndërkombëtar Katolik i Migracionit (ICMC) vazhdojnë të japin kontribute të

---

<sup>11</sup> Mitrovicë/Mitrovica, Zvečan/Zveçan, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Lipjan/Lipljan, Kamenicë/Kamenica, Novobërdë/Novo Brdo, Ferizaj/Uroševac, Viti/Vitina, Prizren, Rahovec/Orahovac, Istog/Istok dhe Klinë/Klina.

rëndësishme në implementimin e projekteve të kthimit përmes financimit, këshillave teknike, mundësimin e vizitave ‘shko dhe vizito’<sup>12</sup> etj. Kjo është e vërtetë gjithashtu për organizata të ndryshme ndërkombëtare qeveritare dhe agjenci. Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) ka qenë posaçërisht aktiv në rajonin e Gjilanit/Gnjilane (komunat: Shtime/Štimlje, Gjilan/Gnjilane, Kamenicë/Kamenica Štrpce/Shtërpçë). UNHCR-ja, DAC-i i UNMIK-ut dhe OSBE-ja vazhdojnë të luajnë një rol të fuqishëm këshillëdhënës në procesin e implementimit të SKK-së.

Rezultatet e anketës tregojnë se në disa komuna, përfaqësuesit e PZHBV-ve, organizatat e PZHBV-ve ose të kthyerit e kanë çuar më tej procesin e implementimit përmes angazhimit të tyre (p.sh. Komuna e Suharekës/Suva Reka), ndërsa në të tjerat ato e kanë penguar procesin përmes mosbashkëpunimit dhe qëndrimit destruktiv. Për shembull, të kthyerit shqiptarë të Kosovës në Štrpce/Shtërpçë, janë tërhequr nga iniciativat e përbashkëta të dakorduara më parë, duke pretenduar se komuniteti serb i Kosovës do të përfitojë padrejtësisht nga ta. Përfaqësuesi i PZHBV-ve serbë të Kosovës në Skenderaj/Srbica, duket se ka qenë më shumë i prirur që t’u japë përparësi interesave personale ndaj interesit të përgjithshëm të tërë komunitetit të zhvendosurve.

## **5. Shqyrtimi i Strategjisë Komunale për Kthim të vitit 2006**

Sipas dokumentit të politikave të UNMIK-IPVQ, shqyrtimi vjetor i SKK-së duhet të bëhet çdo vit në muajin tetor. Nëse zhvillohet në tërësi dhe në kohë të duhur, rezultatet e shqyrtimit mund të shërbejnë si bazë e mirë për të hartuar SKK-në për vitin pasues, si dhe mund të ofrojnë informata mbi sukseset, dështimet, pengesat me të cilat janë ballafaquar etj.

Fatkeqësisht, shqyrtimi i SKK-së për vitin 2006 është zhvilluar vetëm në gjashtë komuna.<sup>13</sup> Në të gjitha këto raste, konkluzionet dhe rekomandimet që kanë dalë nga ky shqyrtim, janë inkorporuar në SKK-në e vitit 2007, duke e bërë atë një dokument më real dhe më të qëndrueshëm.

Në dy komuna janë përdorur sisteme të ndryshme të shqyrtimit. Në Fushë Kosovë/Kosovo Polje, nuk është bërë asnjë shqyrtim vjetor, por zyrtari komunal për kthim dhe përfaqësuesit e komunitetit i kanë raportuar rregullisht GPKK-së. Dhe duke u bazuar në këto raporte janë nxjerrë konkluzione për përshtatje dhe ndryshime, të cilat pastaj janë përfshirë në SKK-në e vitit 2007.

---

<sup>12</sup> ‘Shko dhe vizito’ janë udhëtime për refugjatë ose persona të zhvendosur brenda vendit në vendin e prejardhjes për t’i vizituar pronat e veta, të takohen me fqinjët e mëparshëm dhe të informohen nga përfaqësuesit e pushtetit lokal mbi gjendjen e komuniteteve. Këto udhëtime ‘shko e vizito’ organizohen nga UNHCR-ja dhe/ose njëra nëse është agjenci partnere në bashkëpunim dhe bashkërendim me komunat e prejardhjes, autoritetet lokale dhe komunitetet. Qëllimi është që t’u mundësohet refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vendit të informohen e pastaj të marrin vendime për sa i përket kthimit në vendin e prejardhjes.

<sup>13</sup> Gjakovë/Dakovica, Dragash/Dragaš, Istog/Istok, Rahovec/Orahovac, Podujevë/Podujevo dhe Suharekë/Suva Reka.

Në Komunën e Shtimes/Štimlje është organizuar seminari për zhvillimin e SKK-së, ku janë analizuar SKK-të e viteve të mëparshme. Rekomandimet nga ai seminar janë përfshirë në SKK-në e përmirësuar të vitit 2007. Megjithatë, është dashur një ndërhyrje plotësuese nga UNHCR-i ndaj komunës, për të caktuar objektiva reale dhe të arritshme të SKK-së.

Është vërejtur se në 13 komuna<sup>14</sup>, SKK-ja është bërë pjesë e strategjisë zhvillimore komunale në pajtim me udhëzimet e përgjithshme të parashtruara në Doracakun e Rishikuar për Kthim të Qëndrueshëm, në të cilin thuhet se procesi i hartimit të SKK-së duhet “të lidhet në mënyrë të efektshme me strategjinë zhvillimore komunale, pasi që shumë nevoja të integruara kërkojnë ndërhyrje afatgjata dhe strukturore.”<sup>15</sup>

## **6. Sistemi i përbashkët i raportimit i zyrtarit komunal për kthim dhe ZKK-së**

Në tetor/nëntor të vitit 2006, në bazë të një Letre të Qëllimit të nënshkruar ndërmjet dy ministrive e cila ishte nënshkruar një muaj më herët, u fut në përdorim një sistem i ri i përbashkët raportimi nga zyrtarët komunalë për kthim dhe ZKK-të, si rezultat i një koordinimi dhe bashkëpunimi të intensifikuar ndërmjet Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) dhe Ministrisë për Komunitete dhe Kthim (MKK).

Sipas paragrafit 7 të shabllonit të raportimit, nga zyrtarët komunalë për kthim kërkohet të raportojnë për implementimin e SKK-së, ndërsa paragrafët e tjerë të shabllonit i trajtojnë aspektet e rëndësishme që ndikojnë në gjendjen e komuniteteve pakicë, e që drejtpërdrejt ose tërthortë ndikojnë në kushtet e kthimit. Prandaj, në një rën anë këto raporte janë një instrument i çmuar që u mundëson ZKK-ve dhe zyrtarëve komunalë për kthim t’i vënë në dukje zhvillimet pozitive dhe sfidat me të cilat ballafaqohen gjatë implementimit të SKK-ve. Në anën tjetër, ato u sigurojnë ministrive pranuese informatat më të reja dhe u mundësojnë atyre të përgjigjen në çdo çështje që u drejtohet atyre dhe të ofrojnë ndihmesë të synuar, sipas nevojës.

Vlerësimet e raporteve kanë nxjerrë në pah që, në këto tri komuna (Vushtrri/Vučitrn, Kamenicë/Kamenica dhe Štrpce/Shtërpçë), informatat e ofruara mbi implementimin e SKK-së ishin të cilësisë së lartë, në 12 komuna informatat ishin të nivelit të kënaqshëm, ndërsa në katër komuna të nivelit të dobët. Në shumicën e komunave të vlerësuar, përveç njëjës, raportet janë dorëzuar rregullisht dhe me kohë. Megjithatë, vlerësimi nuk është i plotë për shkak se EK-të e shtatë komunave nuk kanë pasur qasje në këto raporte dhe si rrjedhojë nuk kanë qenë në gjendje për t’i vlerësuar ato.

## **7. Konkluzionet**

Dokumenti i politikave i UNMIK-ut/IPVQ-ve ishte nxjerrë në verën e vitit 2004. Që nga atëherë, kanë ndodhur ndryshime të rëndësishme; është themeluar një ministri e

<sup>14</sup> Deçan/Dečani, Gjakovë/Đakovica, Dragash/Dragaš, Istog/Istok, Kamenicë/Kamenica, Mitrovicë/Mitrovica, Lipjan/Lipljan, Novobërdë/Novo Brdo, Obiliq/Obilić, Podujevë/Podujevo, Suharekë/Suva Reka, Ferizaj/Uroševac dhe Vushtrri/Vučitrn.

<sup>15</sup> Doracak i Rishikuar për Kthim të Qëndrueshëm, korrik 2006, faqe 37, pjesa “Strategjia Komunale e Kthimit”.

re, pra Ministria për Komunitete dhe Kthim dhe një numër i kompetencave janë transferuar nga UNMIK-u te IPVQ-të. Dokumenti i politikave është dokument pune dhe rekomandimet e bëra aty për strukturën e SKK-së, hartimin dhe shqyrtimin duhet të përdoren, sidomos nga komunat që nuk kanë pasur sukses në hartimin, përkrahjen dhe implementimin e suksesshëm të SKK-ve të tyre. Përveç aspektit procedural, do të nevojitet një vullnet më i madh politik dhe përkushtim nga IPVQ-të në të gjitha nivelet për të lehtësuar kthimin e PZHBV-venë komunat e tyre të prejardhjes në mënyrë të sigurt dhe të dinjitoze. Nga rezultatet e anketës ka dalë se, ka modele alternative përpos atij të rekomanduar, që mund të jenë njësoj të suksesshëm. Ekziston nevoja që MKK-ja të zhvillojë më tej dokumentin e politikave dhe të bëjë ndryshime në të, me shembuj të suksesshëm të praktikave të mira të krijuara nëpër komuna.

## **8. Rekomandimet**

Suksesi në implementimin e çfarëdo strategjie ose politike varet nga niveli i pranimit dhe pasjes në pronësi nga aktorët e përfshirë. Sa i përket SKK-së kjo do të thotë se pranimi dhe pronësia nga PZHBV-të dhe komunitetet pranuese është pikërisht e domosdoshme, por edhe kontributi i faktorëve të tjerë relevantë siç janë: përfaqësuesit komunalë, aktorët e shoqërisë civile dhe udhëheqësit e komunitetit nga etapat e më hershme e fazës së planifikimit. Niveli i lartë i transparencës dhe një proces përfshirës e konsultativ i planifikimit janë parakushte të domosdoshme për një përkushtim të vërtetë të të gjitha palëve ndaj procesit të kthimit nëpër komuna. Duke u bazuar në këto procese, janë bërë rekomandime si më poshtë:

### **Për Ministrinë për Komunitete dhe Kthim (MKK):**

- Në bashkëpunim dhe koordinim me MAPL-në, të hartojë një Strategji të Përgjithshme për Kthim, t'i udhëzojë dhe këshillojë komunat gjatë procesit të harmonizimit të SKK-ve me këtë Strategji të Përgjithshme, siç parashihet në PVPE<sup>16</sup>;
- Të forcojë bashkëpunimin dhe koordinimin ndërministror me MAPL-në;
- Të grumbullojë, analizojë dhe shkëmbejë sistematikisht informata me komunat në lidhje me praktikën e suksesshme dhe identifikojë zbrazëtitrat në fushën e planifikimit dhe të implementimit të politikave të kthimit;
- Të rrisë efikasitetin e takimeve të përbashkëta të ZKK-së, zyrtarit komunal për kthim dhe ministrive; të shqyrtojë dhe përpunojë në mënyrë sistematike informatat e siguruar nga raportet e përbashkëta të zyrtarit komunal për kthim dhe ZKK-së dhe t'i trajtojë çështjet e ngritura në raportet e tilla në bashkëpunim dhe koordinim me MAPL-në, siç parashihet në PVPE;<sup>17</sup> dhe
- Të lehtësojë shkëmbimin e rregullt të përvojave dhe të informatave mes zyrtarëve komunal gjegjësisht, duke e kombinuar atë me aftësim dhe ngritje të caktuar të kapaciteteve; dhe të sigurojë udhëzime të përgjithshme dhe këshilla

<sup>16</sup> Plani i Veprimit për Implementimin e Partneritetit Evropian 2006, gusht 2006, Prioriteti nr. 28, Veprimi nr. 4 "Harmonizimi i strategjive komunale për kthim të qëndrueshëm me Strategjinë e Përgjithshme mbi Kthimin".

<sup>17</sup> Plani i Veprimit për Implementimin e Partneritetit Evropian në Kosovë 2006, gusht 2006, Prioriteti i Partneritetit Evropian nr. 28, Veprimi nr. 3 "Forcimi i koordinimit mes MKK-së, MAPL-së, zyrrave komunale për kthim (ZKK-ve) dhe zyrtarëve komunalë për kthim me anë të organizimit të takimeve të rregullta çdo gjashtë javë, për të lehtësuar dhe inkurajuar kthimin e komuniteteve".

për komunitetet rreth mënyrës së forcimit të pjesëmarrjes së PZHBV-venë kthim planifikim të politikave dhe implementim.

#### **Për Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL):**

- Në bashkëpunim dhe koordinim me MAPL-në, të zhvillojë një Strategji të Përgjithshme për Kthim, t'i udhëzojë dhe këshillojë komunitetet gjatë procesit lidhur me harmonizimin e SKK-ve me këtë Strategji të Përgjithshme, siç parashihet në PVPE (shih fusnotën nr. 8);
- Të forcojë bashkëpunimin dhe koordinimin ndërministror me MKK-në;
- Të rrisë efikasitetin e takimeve të përbashkëta të ZKK-së, zyrtarit komunal për kthim dhe ministrive; Të shqyrtojë dhe përpunojë në mënyrë sistematike informatat e siguruar nga raportet e përbashkëta të zyrtarit komunal për kthim dhe ZKK-së dhe t'i trajtojë çështjet e ngritura në raportet e tilla (në bashkëpunim dhe koordinim me MKK-në);
- Të lehtësojë shkëmbimin e rregullt të përvojave dhe të informatave mes zyrtarëve komunalë gjegjësisht, duke e plotësuar me aftësim dhe ngritje të kapaciteteve të caktuara; dhe
- Në bashkëpunim dhe koordinim me MKK-në, të sigurojë që zyrtarët komunalë për kthim dhe aktorët e tjerë komunalë të jenë të vetëdijshëm dhe t'i shfrytëzojnë udhëzimet e përgjithshme procedurale dhe rekomandimet e UNMIK-ut dhe të IPVQ-ve mbi hartimin e SKK-së, t'i zhvillojë dhe rishikojë këto udhëzime të përgjithshme, sipas nevojës.

#### **Për komunitetet:**

- Të përqendrohen në forcimin e PZHBV-ve në planifikimin dhe implementimin e politikave të kthimit;
- Të forcojnë elementin konsultativ në procesin e hartimit të strategjisë, duke iu prezantuar draft strategjinë një game të gjerë të aktorëve komunalë (bashkësive lokale dhe udhëheqësve të tyre, organizatave të shoqërisë civile, etj..) dhe të inkurajojnë kontributin e tyre; dhe
- Të kontaktojnë më aktivisht me komunitetet e PZHBV-ve dhe të lehtësojnë vënien e kontakteve ndërmjet tyre dhe komuniteteve pranuese në komunë përmes organizimit të vizitave 'shko dhe shiko' dhe atyre 'shko dhe informohu' në përputhje me PVPE.<sup>18</sup>

#### **Për komunitetet, përfaqësuesit dhe organizatat e PZHBV-ve:**

- Të kërkojnë kontakte me IPVQ-të e nivelit lokal dhe qendror, posaçërisht me përfaqësuesit komunalë në komunitetet e prejardhjes së personave të zhvendosur;
- Të marrin pjesë aktivisht dhe në mënyrë më konstruktive në mekanizmat e kthimit siç janë GPKK-të;

---

<sup>18</sup> Plani i Veprimit për Implementimin e Partneritetit Evropian në Kosovë 2006, gusht 2006, Prioriteti i Partneritetit Evropian nr. 28, Aksioni nr. 8 "Organizimi i vizitave 'Shko dhe Shiko dhe Shko dhe Informohu', për të ndërtuar kontakte ndërmjet popullatës lokale dhe asaj të zhvendosur, para fillimit të kthimit".



- Të ketë llogaridhënie më të fuqishme nga përfaqësuesit dhe organizatat e PZHBV-ve ndaj komuniteteve të PZHBV-ve në njërin anë, ndërsa në anën tjetër përfshirje dhe konsultim më të fuqishëm me përfaqësuesit dhe organizatat e PZHBV-ve nga ana e IPVQ-ve dhe organizatave ndërkombëtare, për të gjitha çështjet që lidhen me kthimin; dhe
- Të sigurojnë pjesëmarrje dhe përfaqësim të barabartë të interesave dhe brengave të PZHBV-ve, femra dhe të rinj.

**Për organizatat ndërkombëtare:**

- T'i përqendrojnë këshillat dhe mbështetjen e tyre ndaj aktorëve komunalë në përfshirjen më të fuqishme të tyre nëpër aktivitetet kontaktuese dhe afruese me të gjitha komunitetet e PZHBV-ve personave të zhvendosur, kudo që ata janë duke jetuar aktualisht, për të ngritur në shkallë më të lartë rrjedhën e informatave dhe të ngritjen e nivelit të përfshirjes së PZHBV-ve në procesin e planifikimit dhe të implementimit të procesit të kthimit; dhe
- Të sigurojnë përfshirje dhe konsultim me përfaqësuesit dhe organizatat e PZHBV-ve në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me kthimin.

**9. Shtojcat:**

- 1. Dokumenti i Politikave mbi Strategjinë Komunale të Kthimit i UNMIK-ut dhe IPVQ-ve, korrik 2004**